

MARRJA E TË DREJTËS PËR ZGJERIMIN E BE-së NË VITIN 2025 DUKE MARRË NË KONSIDERATË LUFTËN NDAJ KORRUPSIONIT: PIKËPAMJA E SHOQËRISË CIVILE

MOMENTET KRYESORE

Presidenti i Komisionit Evropian e shpalli vitin 2025 si afat përfundimtar për zgjerimin e ardhshëm të BE-së drejt shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe kandidatët më premtues e të mundshëm janë Mali i Zi dhe Serbia. Megjithatë, shtetet anëtare të BE-së nuk janë unanime për sa i përket mbështetjes së kësaj deklaratë. Një numër shtetesh mbështesin këtë zotim si dhe ofrojnë mbështetje ekonomike për një të ardhme Evropiane të rajonit. Sidoqoftë, shqetësimet e vazhdueshme për sa i përket sundimit të ligjit pengojnë Shtetet Anëtare kryesore nga angazhimi i tyre për caktimin e një date specifike për zgjerimin e Ballkanit Perëndimor. BE-ja duhet që në mënyrë të kujdesshme të gjej ekuilibrin mes dëshirës për të siguruar angazhime vepruese për zgjerimin e Ballkanit Perëndimor dhe realitetit të progresit objektivisht të ngadaltë të luftës ndaj korrupsionit në rajon, në mënyrë që të ruajnë shpresat dhe presionin për një ndryshim të hapur në Ballkanin Perëndimor, ndërsa mënjanojnë euroskepticismin në BE.

Sipas 26% të popullsisë, nivelet e korrupsionit në Ballkanin Perëndimor mbeten të larta, pavarësisht faktit se përpjekjet e BE-së kanë shënuar një rënie të qëndrueshme. Progresi ka qenë i ngadaltë dhe i çrregullt. Në rajon nuk është diçka e pazakontë që sukseset e arritura në lidhje me mirëqeverisjen në periudha të caktuara të pasohen me periudha të tjera regresi.Më konkretisht, gjatë periudhës 2014 - 2016 presioni i korrupsionit – treguesi kryesor sasior për nivelet e korrupsionit në rajon –ka rënë në disa vende, por përmirësimi i përgjithshëm në rajon ishte i minimal. Sipas “Studimit të ekonomisë së fshehtë”, i kryer nga rrjeti “Leadershipi i Evropës Juglindore për Zhvillim dhe Integritet” (SELDI, Hidden Economy Survey) dhe sipas burimeve të tjera, **ekonomia e fshehtë zë nga një e katërta (1/4) deri në një të tretën (1/3)** e ekonomive të vendeve të Evropës Juglindore (EJL).

Prandaj, është e domosdoshme që **rritja e planifikuar e mbështetjes së BE për Ballkanin Perëndimor (BP)** të plotësohet me një aktivitet më intensiv dhe me të koordinuar në luftën ndaj korrupsionit, aktivitet i cili të përqendrohet jo vetëm mbi ndihmën teknike nëpërmjet kontratave për shërbime, por edhe **me dhënin e shtytjes dhe përkrahjen e nismave të mirëfillta lokale të shoqërisë civile kundër korrupsionit**. Një ndërhyrje e tillë pozitive mund të luajë rol vendimtar jo vetëm për suksesin e nismave kundër korrupsionit, por edhe në përmirësimin e qeverisjes ekonomike dhe funksionimin e tregut të punës. Prandaj nuk është befasuese që shqetësimet kryesore të listura nga popullsia në EJL në studimin “Barometri Ballkanik 2017” janë pikërisht papunësia (67%), situata ekonomike (46%) dhe korrupsioni (32%).

Pritet që gjatë në vitin 2018 Komisioni Evropian të paraqesë një **Strategji të Përforcuar për Zgjerimin** dhe një Mekanizëm të ri për monitorimin e progresit. Kjo gjë, në këtë fazë të zgjerimit, do të kërkojë të nxisë mbështetjen akoma më të madhe të premtuar, nga Shtetet Anëtare të BE-së për Ballkanin Perëndimor dhe për të siguruar që kushti i BE-së funksionon më mirë, në veçanti në sundimin e ligjit. Pritet që dy Kryesitë e radhës të BE-së nga rajoni – të Bullgarisë dhe të Austrisë – priten që të **sigurojnë një periudhë me rëndësi kritike për mundësinë e favorshme të diskutimit të aderimit**. Njëkohësisht buxheti i BE-së për kuadrin e ardhshëm financiar (2020-2027) do të japë të dhëna suplementare nëse dhe si do të realizohet realisht një zgjerim i tillë.

Elitat politike lokale nga Ballkani Perëndimor kanë sinjalizuar, se preferojnë zgjerim të shpejtë me më pak kushte, duke përfshirë – përpjekjet në drejtim të sundimit të ligjit dhe anti-korrupsionit. Në një seri deklaratash publike në fund të vitit 2017, liderët politikë nga të gjitha vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor shprehën shqetësimin në lidhje me **standardet “e dyfishta” ose “më të ashpra” ndaj vendeve të tyre**, në krahasim me fazat e mëparshme të zgjerimit. Ata shprehën qartë dhe rrezikun e zgjedhjes së një modeli tjetër, si ai i Kinës, Rusisë ose i Turqisë, në rast se nuk ka rrugë të qartë drejtë anëtarësimit në BE. Kjo tregon mungesën e vullnetit të merret përgjegjësia për orientimin strategjik të vendeve të tyre, ashtu dhe brishtësinë e institucioneve, të cilat lehtësisht mund të kapen dhe të shmangen nga interesa private, përfshi edhe të huaja.Ballkani Perëndimor duhet të angazhohet në një bashkëpunimin më të thellë dhe më të gjerë rajonal, në mënyrë që të ndihmojë në justifikimin dhe ruajtjen e inercisë së grumbulluar për mbështetje më të madhe evropiane. Qeveritë do të duhet të demonstrojnë në mënyrë të qartë arritjen e progresit të prekshëm dhe rezultateve konkrete në fushën e anti-korrupsionit, mirëqeverisjes dhe sundimit të ligjit, për të fituar akses dhe për të shfrytëzuar në mënyrë efektive mbështetjen në rritje të BE. Kjo mund të arrihet vetëm platformave gjithëpërfshirëse, të përhapura nëpërmjet **platformave për bashkëpunimin gjithëpërfshirës**, që bashkojnë qeveritë kombëtare, nismat rajonale, aktorët nga Evropa dhe organizatat e shoqërisë civile.

Qeverisja e mirë dhe lufta kundër korrupsionit janë dhe duhet të mbeten prioritetet qendrore për të gjitha fushat e reformës, që të sigurohet një zhvillim i qëndrueshëm ekonomik në rajon. Më konkretisht – zbatimi i mekanizmave që gëzojnë besim për përbalimin e korrupsionit në katet e larta të pushtetit, krahas vazhdimit të ndihmës teknike për uljen e korrupsionit sistematik administrativ. **Pjesëmarrja e shoqërisë civile vazhdon të jetë vendimtare** për arritjen e qëndrueshmërisë së përparimit në luftën kundër korrupsionit. Parimet e nismave vendore, financimi i synuar dhe aksionet e pavarura të shoqërisë civile duhet të përfshihen në mënyrë më bindëse në iniciativat kryesore kombëtare, regjionale dhe evropiane për zhvillimin dhe integrimin e Ballkanit Perëndimor.

Në cilësinë e liderit të ndryshimit në rajon, BE **duhet të krijojë instrumente të politikave, më të përshtatshme me kushtet specifike dhe të punojë në mënyrë të drejtpërdrejtë me grupet lokale të shoqërisë civile** për një luftë efektive kundër korrupsionit. Kjo kërkon **forcimin e nismave rajonale**. Disa nisma të tilla, si për shembull Iniciativa Rajonale Antikorrupsion (IRA) dhe Këshilli Rajonal për Bashkëpunim (RSS), të cilat përbëjnë një platformë të mirë për zhvillim dhe bashkëpunim, duhet të konsolidohen, të zgjerohen dhe modeli i tyre të përhapet më gjerësisht.

Krahas përmirësimit të kapaciteteve teknike dhe rristurimit të kuadrin burokratik, BE duhet të orientohet në **angazhim dhe bashkëveprim më të madh në nivel politik**. Formimi i vullnetit të fortë politik në rajon duhet të fillojë me harmonizimin e axhendës së grupeve të interesit të BE, duke përfshirë Drejtoritë e Përgjithshme të KE, delegacionet lokale të BE, Shërbimin Evropian të Marrëdhënieve të Jashtme, ministrat e jashtëm të shteteve anëtare, partitë politike dhe Parlamentin Evropian, **duke rënë dakord për axhendën përbashkët të mirëqeverisjes me qëllim integrimin e rajonit në BE**.

Ndjekja efektive e korrupsionit të nivelit të lartë është e vetmja mënyrë për të dhënë sinjal të fortë dhe të menjëhershëm, se në Ballkanin Perëndimor nuk do të shfaqet aspak tolerancë ndaj korrupsionit. Është e qartë, se ky është një çmim i lartë politik, i cili kërkohet prej atyre, që me me shumë gjasa do të ulen në tryezën e bisedimeve. Prandaj, është kritike që **BE të vazhdojë të ushtrojë presion të lartë politik** ndërkohë që insiston në ndarjen e pushteteve, demokratizimin dhe de-monopolizimin në Ballkanin Perëndimor.

Krahas kësaj, **përpjekjet kundër korrupsionit duhet të përqendrohen mbi në nivelin e institucioneve publike**, që të mund të monitorojnë cilësinë e zbatimit të politikave dhe planeve të shumta anti-korrupsioni, të miratuara zyrtarisht dhe të mbyllin boshllëqet në zbatimin dhe efektivitetin e tyre.

Kjo kërkesë për qeverisjen e mirë kalon përmes sigurimit të vlerësimit të pavarur, bashkëpunimit efektiv, përmirësimit të performancës institucionale dhe më e rëndësishmja– arritjes së rezultateve të prekshme në luftën kundër korrupsionit. Një **mekanizëm i pavarur i monitorimit të korrupsionit dhe anti-korrupsionit** duhet të implementohet në nivel kombëtar dhe rajonal në mënyrë që të sigurojë të dhëna dhe analiza të forta dhe të integrojë si diagnostikimin e korrupsionit ashtu edhe vlerësimin e politikave anti-korrupsion. Mekanizmi duhet të zbatohet përmes organizatave kombëtare dhe/ose rajonale të shoqërisë civile dhe rrjeteve të pavarura nga qeveritë kombëtare.

Supported by



This website is funded by the European Union. A project implemented by a consortium led by the Macedonian Center for International Cooperation.

Navigation

[History](#)
[Events and News](#)
[Publications](#)
[News from Partners](#)
[Multimedia](#)
[Resources](#)
[Quotable](#)
[Charticle](#)

Executive Secretariat

Macedonian Center for International Cooperation
PO Box 55 st. "Nikola Parapunov" bb
Skopje, Macedonia
Tel: +389 2 3065 381
Fax: +389 2 3065 298

Knowledge and Outreach

Center for the Study of Democracy
5 Alexander Zhendov Str.
1113 Sofia, Bulgaria
Tel: +359 2 971 3000
Fax: +359 2 971 2233
Email: seldi@online.bg

Stay Updated

Full name:

Institution/Organization:

Country:

Your E-mail*:

[unsubscribe](#)

2015 © Copyright Seldi.net.
All Rights Reserved.